



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2021:280790
Datë: 21.03.2024
Numri i dokumentit: 05485712

ARJ.nr.15/2024

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË, kolegji në përbërje nga gjyqtarët: Ragip Namani, kryetar i kolegjit, Nebojša Boričić dhe Muhamet Rexha, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale, Zanë Buçinca, procesmbajtëse, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit, E.A.Ll., nga ..., Komuna e P, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson, Sylejman Klinaku avokat në Prishtinë, kundër të paditurës, Qeveria e Republikës së Kosovës - Zyra për Çështje të Kategorive të Dala nga Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, me bazë juridike nxjerrjen e aktit administrativ, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, parashtruar nga paditësi kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit - Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, AA.nr.218/2023, të datës 27.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë, 21 Mars 2024, merr:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e parashtruar nga paditësi, E.A.Ll., kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit-Departamenti për Çështje Administrative, në Prishtinë AA.nr.218/2023, të datës 27.12.2023.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit-Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, AA.nr.218/2023, të datës 27.12.2023, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit E.A.Ll., ndërsa është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2960/2021 i datës 22.02.2023.

Kundër aktgjykimit të lartë cekur të Gjykatës së Apelit, paditësi për mes të autorizuarit të tij avokat, Sylejman Klinaku, në afat ligjor në Gjykatë Supreme parashtron, kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të: shkeljes së dispozitave të procedurës dhe zbatimit të gabuar të së

drejtës materiale, me propozim që të: I. Aprovohet e bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor dhe II. Aprovohet kërkesëpadia e paditësit si e bazuar në ligj, apo çështja të kthehet në rigjykim ose të ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës AA.nr.218/2023 të datës 27.12.2023 dhe ai i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.nr.2960/2021 të datës 22.02.2023, duke ia njohur paditësit statusin e Veteranit, Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Gjykata Supreme në bazë të nenit 53 të LKA, ka mbajtur seancën e kolegjit, dhe pas vlerësimit të aktgjykimit të atakuar dhe atij të shkallës së parë, sipas theksimeve nga kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor dhe shqyrtimit edhe të akteve tjera të lëndës gjen se:

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se, paditësi me padinë e ushtruar me datë 14.12.2021, kundër të paditurës, Qeveria e Republikës së Kosovës - Zyra për Çështje të Kategorive të Dala nga Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ka kërkuar nga gjykata që të nxjerrë vendimin për zëvendësimin e aktit administrativ të cilin nuk e ka nxjerrë e paditura brenda afatit të përcaktuar ligjor sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1676/18 të datës 01.07.2021, dhe ti njoh paditësit të drejtën e statusit të dëshmorit të kombit, invalidit, veteranit, pjesëtarit apo të internuarit të UÇK-së.

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, në këtë çështje duke vendosur si në kuptim të nenit 5,6,38,43.3,46.2 dhe nenit 68 të LKA-ë pas shqyrtimit në mënyrë meritore të kësaj çështje dhe administrimit të provave në seancë të shqyrtimit kryesor në prani të përfaqësuesit të paditësit dhe në mungesë të palës së paditur, merr aktgjykimin A.nr.2960/2021 të datës 22.02.2023, me të cilin ka vendosur si në vijim: I. Refuzohet si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit E.A.LI., B., Komuna e P., me të cilën ka kërkuar që Gjykata të nxjerr vet aktin administrativ i cili nuk është nxjerrur në afatin e parashikuar nga e paditura si dhe të kompensoj dëmin e shkaktuar me ekzekutimin e aktit administrativ të kontestuar dhe ti njoh të drejtën e statusit të dëshmorit të Kombit, Invalidit të UÇK-së apo të internuarit të UÇK-së. II. Ky aktgjykim zëvendëson aktin e organit kompetent dhe ka karakter të detyrueshëm.

Gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e saj arsyeton ndër të tjera se: Gjykata kishte parasysh nenin 4 paragrafi 4 të Ligji Nr. 04/L-172 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave të Dhunës Seksuale të Luftës, Viktimave Civile dhe Familjarëve të Tyre ku përcaktohet “1.7. Veteran i UÇK –së - pjesëmarrës në luftën për çlirimin në Kosovë si: 1.7.1. Invalid i luftës së UÇK –së –luftëtari, pjesëtar i dhe i internuari (burgosuri) i UÇK- së, i cili ka pësuar plagë , lëndime (dëmtime) fizike dhe psikike apo sëmundje të rënda gjatë luftës ose në burgjet dhe kampet e armikut , gjatë periudhës së luftës , me shkallë të invaliditetit së paku 10%. 1.7.2. Veteran luftarë i UÇK –së – është qytetari i

Kosovës dhe shtetasi i huaj i cili është radhitur në radhët e UÇK- së, dhe është regjistruar si ushtar i armatosur dhe i uniformuar nga komandat, shtabet e zonave operative të UÇK-së, përkatësisht Shtabi i Përgjithshëm i UÇK së, dhe i cili ka qenë aktiv deri në përfundimin e luftës. 1.7.3. I internuar i UÇK së'' – secili person i cili për shkak të veprimtarisë së tij si pjesëtarë i UÇK- së është arrestuar gjatë periudhës 1997 -1999, dhe mbajtur në burg nga forcat e Serbisë. 1.7.4. Pjesëtarë i UÇK së - çdo person i cili me vendim apo akt tjetër është caktuar të kryej detyra konkrete në mbështetje politike, logjistike, financiare dhe detyra të tjera të marra nga komandantët e njëjësive, shtabeve dhe zonave të UÇK- së, përkatësisht shtabi i përgjithshëm i UÇK- së, gjatë periudhës 1997- 1999. 1.7.5. Pjesëmarrës i Luftës - ushtari, i cili është radhitur në radhët e UÇK së , ka qenë i angazhuar në mënyrë aktive për të kontribuar në luftë, por për arsye të ndryshme i ka lëshuar radhët e UÇK- së, para përfundimit të luftës. 1.7.6. Ushtari i zhdukur (i pagjetur) i UÇK- së - veterani ose pjesëtar i UÇK- së, fati i të cilit ende nuk është zbardhur". Gjykata po ashtu kishte parasysh edhe Ligji Nr. 04/L -261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës neni 3 paragrafin 1.3.

Tutje theksohet se: Në bazë të nenit 63 të LKA-së, dispozitat e LPK-së do të zbatohen përshtatshmërisht në rastet kur LKA nuk përmban dispozita për procedurën në konfliktet administrative, andaj bazuar në këtë, gjykata iu referua nenit 7.1 të LPK-së, ku përcaktohet se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*. Nga provat e prezantuara nga paditësi si vërtetim i datës 07.09.1999, vërtetim i datës 03.11.2008, vendim i datës 19.05.2009, vërtetim i datës 17.11.2008, 10.03.2014, ftesë për mobilizim në TMK datës 29.06.2005, mirënjohje e datës 10.12.2008, deklaratë e datës 12.02.2015, vërtetim i datës 26.06.2018, aplikacion i datës 11.02.2013, nuk paraqesin provë të mjaftueshme me të cila do të dëshmonte këtu paditësi se i plotëson kushtet lidhur me njohjen e statusit të pretenduar e i cili në kërkesë referohet në të drejtën e statusit të dëshmorit të Kombit, Invalidit të UÇK-së apo të internuarit të UÇK-së dhe të drejtës së kompensimit, sipas kushteve të përcaktuara në Ligjin për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Ligji për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të Tyre, Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave të Dhunës Seksuale të Luftës, Viktimave Civile dhe Familjarëve të Tyre, për faktin se provat e prezantuara fillimisht referohen si pjesëtar, si vendimi i datës 19.05.2009, vërtetimi i datës 10.03.2014, ai i datës 07.09.99, kurse vërtetimi i datës 03.11.2008 referohet si ushtarë, kurse provat tjera referohen në mobilizim në TMK, andaj fillimisht provat janë kontradiktore në mes vete, të njëjta Gjykatës i janë dorëzuar në kopje dhe si të tilla ishin të pamjaftueshme për të argumentuar pretendimet e paditësit, në mënyrë që gjykata sipas vlerësimit të provave të ketë një vendim ndryshe nga ai në dispozitivin e aktgjykimit Paditësi nuk ka ofruar prova të reja dhe po ashtu nuk ka pasur propozime për prova të reja me të cilat do të dëshmonte se i njëjti i plotëson kushtet për njohjen e statusit dhe po ashtu kompensimin e kërkuar.

Në bazë të kësaj gjendje faktike të vërtetuar, gjykata e shkallës së parë, dhe në bazë të nenit 5, 6, 38, 43 paragraf 3, 46 paragraf 2 dhe 68 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Gjykata e Apelit me aktgjykimin e kontestuar me kërkesë, duke vendosur sipas ankesës së palës paditëse në kuptim të nenit 49 dhe 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA)-së dhe nenit 194 të Ligji për Procedurën Kontestimore (LPK)-së, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të saj si më lartë. Në arsyetim pasi bën përshkrimin e gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, bazuar në shkaqet dhe arsyet po ashtu të njëjta, qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë e pranon në tërësi si të drejtë dhe ligjor, duke vlerësuar se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe drejtë është aplikuar e drejta materiale me refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit. Tutje arsyeton, se pretendimet ankimore të paditësit lidhur me mos vërtetimin e gjendjes faktike nuk janë të bazuara sepse nga provat e paraqitura nga paditësi të administruara nga gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të plotë është vërtetuar se nuk i plotëson kushtet për njohjen e statusit të veteranit luftëtarë, sipas kushteve të parapara me Ligjin nr. 04/L-172 UÇK, për shkak të paraqitjes së provave kontradiktore në mes tyre të cilat ishin të pamjaftueshme për të argumentuar pretendimet e tij, për deri sa i njëjti në gjykatën e shkallës së parë nuk ka ofruar prova të reja dhe nuk ka propozuar ndonjë provë të re as në padi, seancë të shqyrtimit kryesor, detyrim ky që parashihet sipas nenit 7.1 të LPK, të cilat prova do ti referoheshin dëshmisë së strukturës komanduese të ZO Ll., në gjykatë në cilësi dëshmitari për tu dëshmuar se ai ka qenë veteran luftëtar i UÇK dhe pas shqyrtimit të këtyre dëshmimeve do të vërtetohej fakti se i njëjti i plotëson kushtet ligjore për t'iu njohur statusi i veteranit të UÇK-së.

Gjykata Supreme duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes pas shqyrtimit të kërkesës së paditësit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor dhe të provave tjera në shkresat e lëndës, gjen se gjykatat e instancave më të ulëta kanë vendosur drejtë me refuzimin e kërkesë padisë së paditësit nga gjykata e shkallës së parë, dhe ankesës ndaj aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë nga gjykata e shkallës së dytë të kontestuar me kërkesë. Qëndrimin juridik të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore, si të drejtë dhe ligjor në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë, nga se aktgjykimi i kontestuar me kërkesë i Gjykatës së Apelit dhe as ai i shkallës së parë nuk janë të përfshirë me shkelje të dispozitave ligjore të procedurës, apo me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, ashtu si pretendon paditësi.

Pretendimet e paditësit në kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, ku thekson se: në kuptim të nenit 3 paragraf 1.3.2 të Ligjit Nr.04/L-261, paditësi i ka plotësuar kriteret për të qenë Veteran Luftëtar i UÇK-së, sepse paditësi ka qenë pjesëtar i uniformuar nga komanda e UÇK-së, dhe termi pjesëtarë është shprehje e cila është përdorur me rastin e të gjitha vërtetimeve të lëshuara për personat që kanë marr pjesë në luftën e UÇK-së, e të cilët nga e paditura kanë gëzuar statusin e veteranit luftëtar të UÇK-së dhe kanë gëzuar pagesën për mbështetje financiare, e kjo po ashtu mund të vërtetohet nga vërtetimi me nr.prot.560/99 të datës 07.09.99 të lëshuar nga Z.O., e Ll., njësia Komanda, ku citohet se: ushtaraku ka ushtruar këto punë dhe detyra të punës, njësia BR.nr.153, funksioni ushtarë, nga periudha 10.09.1998 deri më datë 07.09.1999, kolegji i Gjykatës Supreme këto pretendime dhe të tjerat si në kërkesë i shqyrtoi

në tërësi në baza ligjore dhe i vlerëson se nuk janë të bazuara në fakte relevante dhe të qëndrueshme në baza ligjore, sepse provat e dorëzuara, përkatësisht vërtetimet në të cilat thirret paditësi, nuk paraqesin prova të mjaftueshme mbi bazën e të cilave do të vërtetohej se paditësi i plotëson kushtet për njohjen e statusit të veteranit luftëtar të UÇK-së, dhe të njëjtat janë edhe kontradiktore me njëra tjetrën.

Në kuptim të nenit 7 paragraf 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) (të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA)) ku përcaktohet se: *“palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*, nenit 319 të LPK-së ku përcaktohet se: *“Secila nga palët ndërgjyqësve ka për detyrë të provoje faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”*, dhe në nenit 322 paragraf 1 ku përcaktohet se: *“Në qoftë se gjykata në bazë të provave të marra (neni 8 i këtij ligji) nuk mund të konstatojë me siguri ndonjë fakt, për ekzistimin e faktit do të përfundojë duke i aplikuar rregullat mbi barrën e provës”* dhe paragraf 2 të tij ku përcaktohet se: *“Pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provoje faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër”*, e ku në rastin konkret paditësi ka dështuar që të argumentoj pretendimet e tij me prova të vlefshme në gjykatat e instancave më të ulëta, ashtu si ceket në arsyetim të aktgjykimeve të tyre të theksuara si më lartë edhe në këtë aktgjykim, andaj nga arsyet e lartcekura edhe kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i ankimuar është i drejtë dhe ligjor.

Mbi këto arsye, Gjykata Supreme e Kosovës konsideron se pretendimet e paditësit janë të pabazuara dhe të pa ndikim për një gjendje ndryshe faktike nga ajo e vërtetuar nga gjykata e shkallës së dytë. Vendimi i kontestuar i gjykatës së shkallës së dytë është i qartë dhe i kuptueshëm. Përveç kësaj, edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë dhe nuk është shkelur ligji në dëm të paditësit.

Nga theksimet si më lartë, e në bazë të nenit 54 paragraf 1 të Ligjit për Konflikte Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME - PRISHTINË
ARJ.nr.15/2024, me datë 21 Mars 2024

B. Profesionale,
Zanë Buçinca

Kryetari i kolegjit,
Ragip Namani